

20232624549

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J

I HUAMARRJES SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT NGA BANKA EUROPIANE E RINDËRTIMIT DHE E ZHVILLIMIT SIPAS MARRËVESHJES SË HUAS PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT PËR VENDKALIMIN E PËRBASHKËT KUFITAR HEKURUDHOR - TABANOVČ

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut detyrohet që të marrë hua nga Banka Europiane e Rindërtimit dhe e Zhvillimit, me vlerë prej 5.000.000 eurove, për financimin e Projektit për vendkalimin e përbashkët kufitar hekurudhor - Tabanovc.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji përcaktohen me Marrëveshjen e huas për financimin e Projektit për vendkalimin e përbashkët kufitar hekurudhor - Tabanovc, e cila do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bankës Europiane të Rindërtimit dhe të Zhvillimit.

Në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Marrëveshjen e huas të paragrafit 1 të këtij neni do ta nënshkruajë ministri i Financave.

Neni 3

Afati i shlyerjes së huas së nenit 1 të këtij ligji është 15 vjet, duke përfshirë periudhën grejs prej katër vjetësh.

Huaja do të shlyhet në 22 këste gjysmëvjetore, më 20 prill dhe 20 tetor të çdo viti, që do të arrijnë për pagesë duke filluar nga data e parë e përfundimit të vitit të katërt nga nënshkrimi i Marrëveshjes së huas.

Norma e interesit është variabile dhe përbëhet nga EURIBOR-i gjashtëmujor i rritur me margjinë prej 1%.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Europiane të Rindërtimit dhe të Zhvillimit provizion të njëhershëm në vlerë prej 1% të vlerës së huas në afat prej shtatë ditëve nga data e fuqizimit të Marrëveshjes së huas.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Europiane të Rindërtimit dhe të Zhvillimit provizion për mjetet e patërhequra në vlerë prej 0.5% të huas në vit.

Provizioni i nenit 2 të këtij neni për mjetet e patërhequra do të fillojë të llogaritet pas 60 ditëve nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes së huas.

Neni 4

Projektin e nenit 1 të këtij ligji do ta zbatojë Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve.

Neni 5

Republika e Maqedonisë së Veriut do ta shlyejë huan e nenit 1 të këtij ligji nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.